



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	08.03.2021
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Shoqata "Autizmi"
Përmes/Preko/Through:	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim



Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën nga Shoqata "Autizmi" me të cilën kërkohet që me datë 5, 6 dhe 7 Prill 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike, Sheshi "Zahir Pajaziti" pasi që muaji Prill në mbar botën njihet si muaji i vetëdijesimit mbi autizmin.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për "Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike" me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin "Zahir Pajaziti" me datën 5,6 dhe 7 Prill 2021 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.